

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët; Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit M.B., nga fshati A., komuna e V., për veprën penale shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri P.nr.21/2017 datë 05.12.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.21/2018 datë 04.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11.06.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit M.B., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri P.nr. 21/2017 datë 05.12.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.21/2018 datë 04.04.2018.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, me aktgjykimin, P.nr. 21/2017 datë 05.12.2017, të dënuarin M.B. e ka shpallur fajtor për veprën penale shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe për këtë vepër i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1

(një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në kohën e verifikimit prej 2 (dy) viteve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguajë në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën në kuptim të nenit 46 par.3 të KPRK, dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim duke ia llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 €. I dënuari është obliguar që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 50 €, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 50 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E dëmtuara Dogana e Republikës së Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest civil. Në kuptim të nenit 69 par.1 lidhur me nenin 318 par.4 të KPRK, gjykata ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të automjeteve të pa doganuara.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.21/2018 datë 04.04.2018, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit kurse aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit av. M.H., nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës aktgjykimet e kundërshtuara t'i ndryshojë, ashtu që të dënuarin ta liroj nga akuza ose që ato të ndryshohen në pikëpamje të vendimit mbi dënimin plotësues-konfiskimin e automjeteve më afër të përshkruara me aktgjykimin e shkallës së parë në atë mënyrë që të njëjtat ti kthehen të dënuarit me obligim që ti paguaj obligimet doganore të parapara me Kodin Doganor të Republikës së Kosovës.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.nr.96/2018 datë 17.05.2018, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat të çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, pretendohet se shkeljet esenciale qëndrojnë në faktin se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i paqartë në pjesën ku konstatohet se i dënuari me qëllim që vetit “ ... ti mundësoi shmangien nga pagesa e tarifave doganore apo tarifave tjera të detyrimeve doganore që paguhen në rast të importimit apo eksportimit të mallrave” dhe me veprimet e tij iu është shmangur obligimeve doganore duke dëmtuar buxhetin e Kosovës në shumë prej 18.662.3 € duke përfshirë këtu edhe akcizën dhe TVSH-ën”. Kjo për arsye se nuk ekziston asnjë provë mbështetëse që vërteton dashjen e të dënuarit M., dhe në anën tjetër nuk ka asnjë bazë të vetme që vërteton faktin se është dëmtuar buxheti i Kosovës për shumën e cekur pasi mjetet nuk janë tjetërsuar e as që në ndonjë mënyrë ato janë vënë në qarkullim. Më tej në kërkesë theksohet se nga përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit nuk kuptohet se mbi bazën e cilave prova prokuroria ka mbështetur pretendimin se i dënuari në mënyrën e përshkruar, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror iu paska shmangur obligimit të pagesave të obligimeve doganore. Në fakt, as prokuroria në akuzën e sajë e as gjykata e shkallës së parë nuk i referohet ndonjë dispozite relevante të Kodit Doganor dhe akcizave në Kosovë. Në të njëjtën mënyrë gjykata e shkallës së dytë si ajo e shkallës së parë në mënyrë përshkruese përpiqet të paraqes përfundimin lidhur me pretendimet ankimore. Njësia e auto krimeve Regjionale në Mitrovicë me rastin e kontrollës në auto sallonin e të dënuarit ka konstatuar se për 9 vetura nuk janë kryer obligimet doganore. I dënuari nuk ka qenë në mundësi që të inicioi fillimin e procedurës së zhdoganimit për shkak të ditëve të vikendit dhe mungesës së mjeteve financiare, dhe nuk ka pasur kurrfarë qëllimi që t’iu shmanget obligimeve ligjore që rrjedhin sipas dispozitave të Kodit Doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se aktgjykimet janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal janë të pabazuara. Siç rezulton nga shkresat e çështjes, aktgjykimi i shkallës së parë i vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së dytë, është i qartë dhe konkret, gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme për fakte vendimtare duke vlerësuar saktësinë e provave kundërtënëse si dhe arsyet ku është bazuar me rastin e vendosjes së kësaj çështje penale-juridike, e sidomos me rastin e vërtetimit të

ekzistimit të veprës penale. Gjykata e shkallës së parë me të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, sikurse janë deklaratat e dëshmitarëve I.I. dhe I.U., që të dy policë hetues të njësisë të Auto krimeve rajonale në Mitrovicë, pastaj provave materiale, certifikatës së biznesit në emër të dënuarit, anekset doganore për automjetet e pa doganuara me nr.001560, 001561, 001562, 001563, 001564, 001565, 001566, 01567 dhe 001568, memorandumimi zyrtar i automjeteve i datës 20.12.2016, për verifikimin e automjeteve, konfirmimi nga dogana për automjetet e pa doganuara dhe vlerën e shmangies së tyre, kanë vërtetuar elementet qenësore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtorë i dënuari.

Nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar rezulton se gjykata ka administruar si provë certifikatën e regjistrimit të biznesit "M.B." me nr. të biznesit, nga e cila vërtetohet fakti se biznesi individual është i regjistruar në emrin e të dënuarit M.B., i cili është pronar i këtij auto salloni dhe selia e tij gjendet në komunën e V. Nga memorandumimi i policisë - njësia e auto krimeve në M., me nr.ref.04/... dt. 20.12.2016, gjykata vërtetoi faktin se nga 13 automjete, 9 automjete kanë rezultuar të pa doganuara. Nga lista e distribuimit e lëshuar nga Dogana e Kosovës e datës 28.12.2016, gjykata vërtetoi faktin se vlera totale për nëntë automjetet e pa doganuara është 50.350.00 €, ndërsa shmangia nga pagesa e doganës, akcizës dhe TVSH-së për këto automjete ka qenë shuma prej 18.662.30 €. Edhe i dënuari M.B. në mbrojtjen e tij e ka pranuar se ditën kritike me rastin e kontrollës që është bërë nga policia e auto krimeve në auto sallonin e tij, 9 veturat kanë qenë të pa doganuara.

Gjykata Supreme vlerëson se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, ndërsa pretendimi i mbrojtësit se me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit nuk qëndrojnë, ngase me të gjitha provat e administruara janë vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari, siç parashihet edhe me ligjin e aplikueshëm.

Po ashtu , kjo gjykatë vlerëson se është i pabazuar pretendimi i mbrojtësit se dënimi plotësues që i është shqiptuar të dënuarit-konfiskimi i automjeteve nuk është në pajtim me ligjin - ngase me dispozitën e nenit 318 par.4 të KPRK, shprehimisht thuhet se,"

mallrat të cilat nuk janë deklaruar saktë apo vlera e pagesës se shmangur, cilado që të jetë më e lartë, konfiskohen, në rastin konkret kemi të bëjmë me normë imperative, e meqenëse gjykata ka konstatuar si në dispozitiv të aktgjykimit se i dënuari është fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, drejtë ka vendosur që të gjitha automjetet për të cilat është vërtetuar se janë të pa doganuara të konfiskohen përherë.

Nga arsyet e dhëna më sipër kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 437 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Pml.nr.131/2018, më datë 11.06.2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa